




ZËRI I QYTETARËVE NË KUVEND:
DEBAT NACIONAL PËR ROLIN E KUVENDIT
NË PROCESIN E **ADERIMIT NË BE**

Anketë debative mbi rolin dhe modelet e
përfshirjes së Kuvendit në integrimin në BE



European
Policy
Institute.
Skopje




NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Përmbajtja:

Hyrja	4
Qëllimi i dokumentit	5
1. Modeli i përfshirjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në BE	6
1.1 Funkcionet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut	6
1.1.1 Funkzioni ligjvënës i Kuvendit dhe cilësia e ligjeve	7
1.1.2 Funkzioni mbikëqyrës i Kuvendit	8
1.1.3 Funkzioni përfaqësues dhe i debatit	9
1.2 Transparenca dhe besimi	10
1.3 Argumente	11
2. Trupat punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procesi i integrimit në BE	13
2.1 Funksionimi i Kuvendit në procesin e BE-së	13
2.2 Trupat kryesore të punës së Kuvendit në procesin e integrimit në BE	14
2.3 Perspektivë krahasuese (Kroaci–Slloveni–Shqipëri)	15
2.3.1 Kroacia: procedura urgjente si një vendim i dukshëm e i qartë parlamentar	16
2.3.2 Sllovenia: përshpejtimi përmes shkurtimeve të fazave të debatit	16
2.3.3 Shqipëria: përshpejtimi me “prag minimal kohor” si kornizë mbrojtëse	17
2.4 Argumente	18



Hyrja

Parlamenti është institucion qendror i çdo sistemi demokratik. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut këtë rol e ka Kuvendi, përmes së cilit qytetarët shprehin dhe institucionalizojnë vullnetin e tyre politik. Përmes zgjedhjes së deputetëve, ata delegojnë të drejtën për të vendosur mbi çështje kyçe shoqërore, që përbën bazën e demokracisë përfaqësuese.

Megjithatë, pozita formale kushtetuese e Kuvendit nuk përputhet gjithmonë me perceptimin e publikut. Në vitet e fundit, në diskursin politik të Maqedonisë së Veriut, gjithnjë e më shpesh është shtruar dilema nëse Kuvendi përbën realisht qendrën kryesore të vendimmarrjes, apo nëse marrëveshjet dhe vendimet politike kyçe krijohen jashtë sallës plenare, në selitë partiake, në kuadër të pushtetit ekzekutiv ose në rrethe joformale politike.

Kuvendi ka tri funksione klasike: funksionin legjislativ, mbikëqyrës dhe përfaqësues. Ai miraton ligje, mbikëqyr punën e Qeverisë dhe i artikulon interesat e grupeve të ndryshme shoqërore. Megjithatë, cilësia e demokracisë nuk matet vetëm me numrin e ligjeve të miratuara, por edhe me mënyrën se si ato miratohen. Debatit thelbësor, shqyrtimi serioz i amendamenteve, hapësira e opozitës që të ndikojë, cilësia e diskutimeve në komisione dhe transparenca e procesit, janë elemente kyçe. Në kontekstin e integritetit evropian, të agjendës së reformave dhe të paketave komplekse ligjore që lidhen me harmonizimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, roli i Kuvendit bëhet edhe më i rëndësishëm. Procedurat e përshpejtuara, miratimi i ligjeve me procedurë të shkurtuar ose me “flamur evropian”, që në praktikë nënkupton afate më të shkurtra, debat të kufizuar dhe kalim më të shpejtë nëpër procedurën legjislative, shpesh nxisin dilema lidhur me balancën ndërmjet efikasitetit dhe debatit demokratik.

Njëkohësisht, besimi i publikut në Kuvend është një tregues i ndjeshëm i shëndetit të demokracisë. Kur qytetarët e perceptojnë Kuvendin si një arenë konfliktesh partiake pa ndonjë efekt real mbi politikën, dobësohet bindja se zëri i tyre ka peshë. Nga ana tjetër, kur Kuvendi përjetohet si një hapësirë për debat të argumentuar, kjo e forcon legjitimitetin e sistemit politik.

Kjo situatë shtron dilemën nëse Kuvendi merr vendime në mënyrë të pavarur nga Qeveria dhe nëse deputetët i përfaqësojnë qytetarët apo veprojnë kryesisht si dorë e zgjatur e partive dhe e udhëheqjeve partiake. Po ashtu, shtrohet edhe dilema lidhur me efikasitetin e mekanizmave të mbikëqyrjes parlamentare dhe nëse procedurat shërbejnë për debat të mirëfilltë apo janë vetëm formalitet.



Qëllimi i dokumentit

Ky dokument synon të ofrojë një bazë të qartë dhe të strukturuar për reflektim dhe diskutim mbi rolin dhe funksionimin e Kuvendit, me theks të veçantë në procesin e anëtarësimit të shtetit në Bashkimin Evropian.

Më konkretisht, dokumenti:

- shpjegon funksionet themelore të Kuvendit në sistemin kushtetues dhe politik;
- identifikon sfidat strukturore në funksionimin e tij;
- shqyrton argumentet “pro” dhe “kundër” të interpretimeve të ndryshme të rolit të tij;
- mundëson hapësirë për rishqyrtim kritik të marrëdhënies ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv;
- nxit debat publik të informuar, të argumentuar dhe gjithëpërfshirës.

A janë të balancuara dhe të paanshme informacionet e përfshira në këtë dokument?

Në kuadër të procesit të përgatitjes, dokumenti është përgatitur nga Dr. Gordan Georgiev, ndërsa recensionin është kryer nga Mr. Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq.

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti ishte shumë e rëndësishme që informacionet e paraqitura të jenë objektive, të balancuara dhe të paanshme. Në këtë drejtim, të gjashtë grupet parlamentare në Kuvend u ftuan të jenë pjesë e Grupit Këshillëdhënës të projektit “Nxitja e pjesëmarrjes publike në dialog konstruktiv politik”, prej të cilave pjesëmarrjen e konfirmuan: “Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë tonë”; koalicioni “Fronti Evropian”; koalicioni “Maqedonia jote”; koalicioni “Për një të ardhme evropiane” dhe koalicioni “VLEN”. Në këtë drejtim, për materialet informuese u konsultuan koordinatoret e grupeve parlamentare që konfirmuan pjesëmarrjen, në cilësinë e anëtarëve të Grupit Këshillëdhënës, si dhe ekspertë me përvojë dhe me pikëpamje të ndryshme mbi temat.

1. Modeli i përfshirjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në BE

“

Në demokracitë parlamentare, parlamenti është institucion kyç përmes së cilit qytetarët e ushtrojnë vullnetin e tyre politik. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, këtë rol e ka Kuvendi, i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1991, me të cilën është vendosur një sistem parlamentar, në të cilin Qeveria buron nga shumica parlamentare dhe i përgjigjet asaj.

”

1.1 Funkcionet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kuvendi, formalisht, ka kompetenca kyçe, si zgjedhja dhe kontrolli i Qeverisë, miratimi i buxhetit, ratifikimi i marrëveshjeve dhe miratimi i ligjeve. Ky rol është veçanërisht i rëndësishëm në periudha të ndryshimeve të mëdha politike dhe institucionale, si ndryshimet kushtetuese pas vitit 2001 dhe reformat eurointegruese. Në publik ekzistojnë perceptime të ndryshme mbi rolin e Kuvendit, veçanërisht për shkak të periudhave historike të dominimit të pushtetit ekzekutiv dhe krizave politike. Shtrohet pyetja nëse Kuvendi është vërtet qendra e vendimmarrjes apo nëse vendimet kyçe merren në kuadër të pushtetit ekzekutiv dhe strukturave partiake.

Një argument është se Kuvendi ka fuqi reale dhe thelbësore, sepse pa votimin e tij asnjë ligj nuk mund të hyjë në fuqi dhe asnjë qeveri nuk mund të funksionojë. Deputetët kanë të drejtë të propozojnë ligje dhe amendamente, e miratojnë Buxhetin e shtetit, nxisin debate dhe kërkojnë llogaridhënie nga Qeveria. Në këtë drejtim, Kuvendi është qendra institucionale e sistemit demokratik.

Nga ana tjetër, Qeveria zakonisht e propozon pjesën më të madhe të ligjeve dhe e kontrollon dinamikën e miratimit të tyre. Modeli zgjedhor dhe disiplina partiake e forcojnë rolin e partive, ndërsa vendimet kyçe shpesh harmonizohen jashtë debatit parlamentar. Si rrjedhojë, hapësira për veprim të pavarur të deputetëve është e kufizuar, ndërsa roli i tyre shpesh reduktohet në konfirmim formal të qëndrimeve të dakorduara paraprakisht. Mënyra se si qytetarët e konsiderojnë këtë raport është i rëndësishëm për legjitimitetin e gjithë sistemit demokratik. Nëse Kuvendi konsiderohet si një hapësirë aktive për debat dhe për vendimmarrje, besimi mund të jetë më i lartë. Nëse, përkundrazi, konsiderohet si institucion që kryesisht i konfirmon vendimet e marra diku tjetër, kjo mund të ndikojë në shkallën e angazhimit politik dhe të besimit.

1.1.1 Funkzioni ligjvënës i Kuvendit dhe cilësia e ligjeve

Një nga funksionet kyçe të Kuvendit është miratimi i ligjeve, të cilat e rregullojnë funksionimin e institucioneve dhe jetën e përditshme. Cilësia e ligjeve ndikon drejtpërdrejt në sigurinë juridike dhe në besimin ndaj institucioneve dhe nuk varet vetëm nga përmbajtja e tyre, por edhe nga procedura e miratimit. Rregullorja e Kuvendit e rregullon këtë procedurë, teksa faktorë të rëndësishëm janë koha për të realizuar debat, mundësia për paraqitjen e amendamenteve, përfshirja e ekspertëve dhe e publikut, si dhe transparenca.¹

Sipas Rregullores, ligjet mund të miratohen me procedurë të rregullt, të shkurtuar ose përshpejtuar. Procedura e rregullt parashikon disa lexime, debat në komisione dhe afat më të gjatë për paraqitjen e amendamenteve. Kjo qasje mundëson analizë më të hollësishme dhe debat më të gjerë. Në periudhat kur Kuvendi ka funksionuar me shumicë stabile dhe me shkallë relativisht të ulët të polarizimit politik, procedura e rregullt ka mundësuar debat më të thellë dhe përfshirje të aktorëve të ndryshëm.

Megjithatë, praktika parlamentare në Maqedoninë e Veriut shënon edhe përdorim të konsiderueshëm të procedurës së shkurtuar për miratimin e ligjeve, sidomos në periudha reformash intensive ose krizash politike. Procedura e shkurtuar mundëson miratim më të shpejtë të ligjeve, që mund të arsyetohet në kushte kur ka urgjencë ose harmonizim obligime ndërkombëtare, veçanërisht në kuadër të integritetit evropian.

Nga njëra anë, harmonizimi me legjislacionin evropian të BE-së kërkon shpejtësi dhe efikasitet, prandaj procedura e shkurtuar shpesh arsyetohet si mënyrë për të shmangur zvarritjen dhe bllokimin e reformave. Megjithatë, theksohet se çdo ligj ka pasoja politike dhe shoqërore dhe, pavarësisht prejardhjes së tij, duhet të jetë objekt i një debati thelbësor.

Përdorimi i shpeshtë i procedurave të shkurtuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut hapi debat për cilësinë e legjislacionit dhe përfshirjen e procesit, sidomos në raport të rolit të opozitës dhe publikut ekspert. Afatet e shkurtra mund të krijojnë perceptimin për ndikim të kufizuar të Kuvendit mbi ligjet. Kjo ngre një dilemëmë të gjerë ndërmjet efikasitetit dhe demokracisë, ku balanca varet nga konteksti, transparenca dhe besimi i qytetarëve.

1 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Деловник на Собранието на Република Северна Македонија), 24.11.2023. Vegëza: <https://bit.ly/481xmaD>.

Funksioni ligjvënës i Kuvendit, veçanërisht në kushtet e agjendës reformuese dhe të integritimit evropian, nuk është vetëm proces teknik, por edhe pjesë kyçe e legjitimitetit demokratik të institucioneve. Mënyra se si miratohen ligjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndikon mbi besimin në Kuvend dhe mbi bindjen e qytetarëve se janë të informuar për vendimet që merren, se marrin pjesë në këtë proces dhe se këto vendime merren në interesin e tyre.

1.1.2 Funksioni mbikëqyrës i Kuvendit

Përveç funksionit ligjvënës, Kuvendi luan rol kyç në mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv, ndërsa Qeveria, ndonëse e zgjedhur nga shumica parlamentare, i përgjigjet Kuvendit. Ky ekuilibër ndërmjet bashkëpunimit dhe kontrollit është një element themelor i sistemit demokratik të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1991. Funksioni mbikëqyrës ushtrohet përmes mekanizmave të ndryshëm: pyetjeve parlamentare, seancave dëgjimore mbikëqyrëse, interpelancave, komisioneve anketuese, votës së besimit ndaj Qeverisë, shqyrtimit të raporteve të Qeverisë dhe të institucioneve të pavarura, si dhe përmes debateve publike për politika konkrete. Këta mekanizma rregullohen më tej me Rregulloren e Kuvendit, e cila përcakton procedurat për mbikëqyrje dhe kontroll parlamentar.²

Në teori, këta mekanizma sigurojnë kontroll mbi pushtetin ekzekutiv, rrisin transparencën dhe mundësojnë llogaridhënie publike. Përmes pyetjeve parlamentare, Qeveria duhet të japë përgjigje për politikën dhe veprimet e saj. Përmes komisioneve anketuese mund të hetohen raste ose ngjarje të caktuara me interes publik. Interpelanca mundëson të hapet debat për përgjegjësinë e një funksionari të caktuar. Vota e besimit ndaj Qeverisë është instrumenti më i fortë i kontrollit parlamentar, pasi mund të çojë në rrëzimin e Qeverisë. Debatet mbikëqyrëse, ndërkaq, shërbejnë për të mbledhur informacione dhe mendime ekspertësh për fushë konkrete të veprimtarisë së pushtetit ekzekutiv.

Historikisht, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka kaluar nëpër faza të ndryshme sa i përket ushtrimit të funksionit mbikëqyrës. Në vitet e para pas pavarësisë (1991–2001), Kuvendi shpesh funksiononte në kushte të dominimit të fortë të pushtetit ekzekutiv dhe të një pjekurie të kufizuar institucionale. Pas vitit 2001 dhe ndryshimeve kushtetuese të lidhura me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, u forcua roli i komisioneve parlamentare dhe u zgjeruan mundësitë për debat mbi çështje të ndjeshme me interes publik. Në periudhën e fundit, sidomos pas krizës politike prej 2015 gjer më 2017, çështja e mbikëqyrjes parlamentare fitoi peshë shtesë në debatin publik, si pjesë e diskutimeve më të gjera për sundimin e ligjit dhe përgjegjësinë institucionale. Megjithatë, në praktikë, përshtypja për efektivitetin e mbikëqyrjes në kontekstin e Maqedonisë së Veriut mund të ndryshojë. Nga njëra anë, roli mbikëqyrës i Kuvendit mund të konsiderohet thelbësor. Deputetët kanë në dispozicion një kornizë të fortë mbikëqyrëse, e cila, nëse zbatohet në vazhdimësi, mund të ndikojë ndjeshëm në funksionimin, mënyrën e punës dhe llogaridhënien e Qeverisë. Një shembull i suksesshëm vitevetë fundit është debati mbikëqyrës për zbatimin e dispozitave të Ligjit për personat e paevidentuar në librin amë të të lindurve, i cili rezultoi në ndryshime ligjore që u mundësoi personave pa dokumente të fitojnë identitet juridik. Parashtrimi i pyetjeve nga deputetët krijon presion për llogaridhënie, ndërsa ekzistenca e mbikëqyrjes parlamentare mund të ketë edhe efekt parandalues, duke nxitur një nivel më të lartë llogaridhënieje të bartësit e funksioneve ekzekutive.

2 Instituti parlamentar, Kontrolli politik dhe mbikëqyrja e kuvendit mbi qeverinë dhe mbajtësit e tjerë të funksioneve publike (Политичка контрола и надзор на Собранието над Владата и над другите носители на јавни функции), 03.2014. Vegëza: <https://bit.ly/4cpSDvY>.

Nga ana tjetër, theksohet se mbikëqyrja shpesh mbetet formale ose e kufizuar nga dinamikat partiake. Polarizimi i fortë politik dhe mungesa e konsensusit për çështje kyçe ndërmjet deputetëve, si dhe disiplina partiake dhe koordinimi brenda grupeve parlamentare, ndikojnë në rezultatin e interpelancave, seancave dëgjimore mbikëqyrëse dhe komisioneve anketuese. Viteve të fundit, si shembull i një përpjekjeje të pasuksesshme për mbikëqyrje është puna e komisionit anketues për skandalin në Klinikën Universitare për Radioterapi dhe Onkologji. Ky komision përfundoi me dy grupe konkluzionesh, për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe konsensusit ndërmjet deputetëve të shumicës dhe të opozitës.

Për më tepër, dukshmëria e funksionit mbikëqyrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut varet si nga mbulimi mediatik, ashtu edhe nga interesi i publikut. Nëse seancat dhe debatet në komisione nuk ndiqen më gjerësisht, ndikimi i tyre në mënyrën se si i shohin qytetarët këto procese mund të jetë i kufizuar. Njëkohësisht, niveli i ulët i besimit në institucione, i evidentuar në anketa të ndryshme të opinionit publik gjatë dekadës së fundit, tregon se një pjesë e qytetarëve nuk e konsiderojnë efektiv funksionin mbikëqyrës.³

Funksioni mbikëqyrës përbën një tregues të rëndësishëm të ekuilibrit të pushtetit në sistemin politik të Maqedonisë së Veriut. Prandaj, pyetja nuk është vetëm nëse ekziston mbikëqyrje, por edhe cili është karakteri, intensiteti dhe efekti i saj real në kontekstin konkret institucional.

1.1.3 Funksioni përfaqësues dhe i debatit

Demokracitë bashkëkohore përpiqen ta zgjerojnë mundësinë e pjesëmarrjes edhe ndërmjet cikleve zgjedhore. Kështu, qytetarët përfshihen përmes:

- **debateve publike për projektligje,**
- **nismave qytetare,**
- **peticioneve,**
- **komunikimit me deputetët,**
- **takimeve me deputetët në zyrat lokale për kontakt me qytetarët,**
- **pjesëmarrjes përmes organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të ekspertëve.**

Në kontekstin e integritit evropian, këta mekanizma janë akoma më të rëndësishme. Një pjesë e proceseve reformuese, të lidhura me harmonizimin me legjislacionin evropian, kërkojnë konsultime me palët e interesuara, ekspertët dhe shoqërinë civile. Në këtë mënyrë, përfshirja e procesit ligjvënës bëhet pjesë e standardeve më të gjera të qeverisjes demokratike, të lidhura me integrimin evropian.⁴ Pyetja është se sa ndikim real kanë këta mekanizma mbi vendimet përfundimtare. Një argument është se vetë ekzistenca e këtyre mekanizmave përbën dëshmi të hapjes së sistemit. Ligji parashikon debate publike, komisionet mund të ftojnë ekspertë, ndërsa çdo qytetar, formalisht, mund t'i drejtohet përfaqësuesit të vet të zgjedhur. Në këtë kuptim, ekziston një kornizë institucionale për pjesëmarrje.

3 Jovevska Gjorgjievqi, A., Treneska, J., Një vështrim në Kuvend: Perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Поглед на Собрание: перцепциите на граѓаните за работата на Собранието на Република Северна Македонија), Institutit për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSC), 2024. Vegëza: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2024/10/MKD-TERENSKA_ANKETA_2024.pdf

4 Kocevski, G. (2025). The Parliament of North Macedonia in the Advent of Accession Negotiations with the European Union: Bystander or Actor?. Central European Academy Law Review, 2(1). Vegëza: <https://doi.org/10.62733/2024.1.125-146>

Një argument tjetër është se ndikimi i pjesëmarrjes qytetare shpesh kufizohet nga konteksti politik, veçanërisht kur vendimet kyçe janë dakorduar paraprakisht. Për më tepër, niveli i ulët i informimit dhe i përfshirjes së qytetarëve e vë në pikëpyetje shkallën e përfshirjes në proces.⁵

Lind dilema nëse përgjegjësia për pjesëmarrje u takon qytetarëve apo institucioneve. Teksa disa e theksojnë rolin aktiv të qytetarëve, të tjerë thonë se institucionet duhet ta nxisin në mënyrë proaktive pjesëmarrjen e informuar, veçanërisht në proceset komplekse të reformave. Hendeku ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve buron nga informimi i pamjaftueshëm, procedurat e ndërlikuara dhe mosbesimi. Në kontekstin e reformave të BE-së, shtrohet pyetja nëse ato shihen si një proces i përbashkët demokratik dhe nëse ekzistojnë mekanizma që mundësojnë pjesëmarrje reale dhe kuptim-plote të qytetarëve.⁶

1.2 Transparenca dhe besimi

Transparenca është themel i besimit në institucione dhe nuk nënkupton vetëm publikimin e informacionit, por edhe ofrimin e informacionit të qasshëm dhe të kuptueshëm. Vetëm në këtë formë qytetarët mund të informohen për ligjet, t'i ndjekin proceset dhe t'i kuptojnë pasojat e vendimeve. Në aspekt formal, parlamentet sot kanë më shumë mekanizma transparence se në të kaluarën. Seancat transmetohen drejtpërdrejt, dokumentet publikohen në internet, rendi i ditës është i qasshëm publikisht, ndërsa ekzistojnë edhe garanci ligjore për qasje në informacione me karakter publik.⁷

Nga njëra anë, kjo mund të konsiderohet si një nivel i mjaftueshëm transparence. Nga ana tjetër, shtrohet pyetja nëse qasshmëria formale nënkupton edhe transparencë thelbësore. Transparenca thelbësore shpjegon edhe pasojat e ligjeve, përkatësisht mënyrën se si ato ndikojnë në jetën e përditshme dhe pse reformat janë të domosdoshme. Prandaj hapet dilema nëse transparenca matet sipas përmbushjes formale apo sipas asaj sa qytetarët e kuptojnë, e shfrytëzojnë dhe përfshihen në procese.

Besimi në Kuvend është një tregues kyç i sistemit demokratik dhe varet nga mënyra se si funksionon institucioni. Ai lidhet me cilësinë e ligjeve, transparencën, mbikëqyrjen dhe debatin publik.

5 Jovevska Gjorgjieviq, A., Treneska, J., Një vështrim në Kuvend: Perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Поглед на Собрание: перцепциите на граѓаните за работата на Собранието на Република Северна Македонија), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSC), 2024. Vegëza: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2024/10/MKD-TERENSKA_ANKETA_2024.pdf

6 Kocevski, G. (2025). The Parliament of North Macedonia in the Advent of Accession Negotiations with the European Union: Bystander or Actor?. *Central European Academy Law Review*, 2(1). Vegëza: <https://doi.org/10.62733/2024.1125-146>

7 Jovevska Gjorgjieviq, A., Treneska, J., Raport nga fokus grupet: perceptimi publik i punës së Kuvendit, besimi në institucionet publike dhe partitë politike dhe cilësia e jetës në Maqedoninë e Veriut (Извештај од фокус групи: јавната перцепција за работата на Собранието, довербата во јавните институции и политичките партии и квалитетот на животот во Северна Македонија), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSC), 2025. Vegëza: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2025/12/A4_MKD-FOKUS_GRUPI_2025.pdf.

Jovevska Gjorgjieviq, A., Treneska, J., Një vështrim në Kuvend: Raport mbi vëzhgimin e cilësisë së debatit në Kuvend (Janar – Qershor 2025) (Поглед на Собрание: извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието (јануари – јуни 2025)), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSC), 04.2025. Vegëza: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2025/12/A4_Kvalitet_na_debata_jan_jun_2025MKD.pdf

Një argument është se besimi i ulët në Kuvend shpjegohet edhe me kontekstin më të gjerë politik dhe polarizimin, por edhe me vlerësime konkrete për mënyrën se si funksionon, siç janë, ndikimi partiak dhe debati i kufizuar. Informimi mund ta rrisë besimin, por edhe qasjen kritike. Besimi varet nga fakti nëse qytetarët ndiejnë se zëri i tyre përfaqësohet realisht dhe nga mënyra se si institucioni i ushtron kompetencat e veta.

Organizatave e shoqërisë civile shpesh veprojnë si ndërmjetës midis institucioneve dhe publikut, duke ofruar ekspertizë dhe duke nxitur debat publik.

Shtrohet pyetja nëse organizatat e shoqërisë civile e përfaqësojnë publikun më të gjerë, pasi ato shpesh përfaqësojnë interesa dhe tema specifike. Pjesëmarrje e kufizuar e të njëjtit rrjet organizatash mund të krijojë përshtypjen e mungesës së përfshirjes së mjaftueshme dhe ta mbajë debatin brenda një rrethi të ngushtë, në vend që ta zgjerojë atë drejt qytetarëve.

1.3 Argumente

Opsioni	Argumente “pro” / Mundësi	Argumente “kundër” / Sfidat
Kuvendi si qendër e vendimmarrjes politike	Pa vendim të Kuvendit nuk mund të miratohet asnjë ligj, as Buxheti i shtetit, dhe as të funksionojë Qeveria.	Në praktikë, vendimet kyçe shpesh formësohen në pushtetin ekzekutiv ose në strukturat partiake.
Autonomi më e madhe e deputetëve	Deputetët me më shumë autonomi mund të debatojnë më thellësisht, të propozojnë amendamente dhe të ushtrojnë kontroll.	Autonomia e tepruar mund ta dobësojë kohezionin e shumicës parlamentare, ta zvogëlojë parashikueshmërinë e vendimmarrjes politike dhe ta vështirësojë procesin me të cilin partitë mbajnë përgjegjësi për politikën që ua kanë premtuar qytetarëve.
Procedura e rregullt ligjvënëse	Mundëson analizë më të hollësishme, debat më të gjerë dhe përfshirje më të madhe të aktorëve të ndryshëm.	Procedura më e gjatë mund ta ngadalësojë miratimin e ligjeve në periudha urgjence ose reformash.
Procedura e shkurtuar dhe urgjente	Mundëson miratim më të shpejtë të ligjeve kur ka nevoja urgjente ose detyrime ndërkombëtare.	Mund të krijojë përshtypje për mospërfshirjetë mjaftueshme dhe ndikim të kufizuar në tekstin përfundimtar.
Shpejtësia në harmonizimin me BE-në	E forcon aftësinë e shtetit për t’i përmbushur me kohë detyrimet nga integrimi evropian.	Mund ta kufizojë hapësirën për debat thelbësor publik dhe parlamentar, dhe me këtë edhe mundësinë për t’i përshtatur si duhet zgjidhjet evropiane me kontekstin vendor.

Funksioni i fortë mbikëqyrës i Kuvendit	Përmes pyetjeve parlamentare, interpelancave, seancave dëgjimore mbikëqyrëse dhe komisioneve anketuese rritet llogaridhënia e pushtetit ekzekutiv.	Nëse mbikëqyrja përdoret për përballje politike, mund të çojë në bllokime dhe politizim partiak, ndërsa kur Qeveria gëzon mbështetje të qëndrueshme, mund të mbetet formale dhe e kufizuar.
Debati publik si hapësirë për diskutim të gjerë	Mundëson përfshirje më të gjerë të qytetarëve, ekspertëve dhe palëve të interesuara, përmirëson cilësinë e ligjeve dhe rrit besimin në vendimmarrje.	Meqë rekomandimet nga debatet publike nuk janë detyruese, ekziston rreziku që ato të mbeten formale dhe pa ndikim real, duke zvarritur procesin ligjvënës.
Opozita si faktor korigjues në procesin ligjvënës	Mund të kontribuojë në kontroll më të mirë të shumicës, amendamente më cilësore dhe debat më të hapur.	Nëse roli i opozitës përqëndrohet më së shumti në bllokim ose zvarritje, procesi mund të ngadalësohet pa përmirësim thelbësor të ligjeve.
Përfshirja e qytetarëve në punën e Kuvendit	Përfshirja më e madhe e qytetarëve mund të kontribuojë në kuptim më të mirë të nevojave publike, zgjidhje ligjore më cilësore dhe besim më të madh në procesin e vendimmarrjes.	Ndikimi real shpesh varet nga konteksti politik dhe nga gatishmëria e institucioneve për t'i marrë parasysh propozimet e qytetarëve.
Roli proaktiv i institucioneve në përfshirjen e qytetarëve	Informimi aktiv dhe afrimi i proceseve me qytetarët rrit përfshirjen dhe besimin.	Nëse institucionet nuk përpiqen, pjesëmarrja mbetet formale dhe e kufizuar në një numër të vogël qytetarësh aktivë.
Transparenca formale	Publikimi i dokumenteve, rend i ditës dhe transmetimi i seancave sigurojnë një nivel bazë të transparencës.	Qasshmëria formale nuk do të thotë domosdoshmërisht se informacioni kuptohet nga publiku.
Transparenca thelbësore	Shpjegimi i pasojave të ligjeve ndihmon qytetarët të kuptojnë se si reformat ndikojnë në jetën e tyre.	Ekziston rreziku që publikut t'i paraqitet një pasqyrë selektive e zgjidhjeve ligjore, me qëllim të ndikimit në perceptimin publik.
Informim më i madh i qytetarëve	Informimi më i mirë mund të kontribuojë në rritjen e përfshirjes dhe cilësinë së debatit publik.	Rritja e sasisë së informacioneve nuk garanton informim cilësor nëse mungojnë të dhëna të qarta dhe të kuptueshme.
Organizatrat e shoqërisë civile si ndërmjetëse	Ofrojnë ekspertizë dhe ndihmojnë në artikullimin e interesave të grupeve të caktuara.	Mund të krijohet përshtypja se përfaqësojnë vetëm një rreth të ngushtë, jo publikun e gjerë.

2. Trupat punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procesi i integritimit në BE

2.1 Funkcionimi i Kuvendit në procesin e BE-së

Integrimi evropian kërkon harmonizim të shpejtë të legjislacionit, ndërsa Kuvendi ka një rol të dyfishtë: të sigurojë efikasitet dhe legjitimitet demokratik përmes transparencës, debatit publik dhe përfshirjes së palëve të interesuara. Një nga dilemat qendrore në këtë proces është raporti ndërmjet shpejtësisë dhe demokracisë. Argumentet në favor të miratimit të përshpejtuar të ligjeve që lidhen me agjendën evropiane theksojnë se harmonizimi shpesh ka karakter teknik dhe se dinamika e procesit negociues kërkon një ritëm të caktuar. Nëse ligjet nuk miratohen në kohë, procesi i integritimit mund të ngecë.

Nga ana tjetër, theksohet se çdo ligj, edhe kur është me “flamur evropian”, ka pasoja konkrete shoqërore dhe politike. Mënyra se si zbatohen standardet evropiane mund të ndryshojë dhe të hapë hapësirë për zgjidhje të ndryshme.⁸ Transpozimi i drejtpërdrejtë i legjislacionit evropian në kontekstin vendor, pa u përshtatur mjaftueshëm me kushtet institucionale, politike dhe shoqërore, mund të krijojë vështirësi shtesë në zbatim. Për këtë arsye, debati publik dhe debati parlamentar nuk janë vetëm formalitet, por pjesë thelbësore e procesit reformues.

Agjenda e reformave të BE-së nënkupton harmonizimin e legjislacionit me legjislacionin evropian, por edhe forcimin e standardeve institucionale, përfshirë llogaridhënien, transparencën dhe cilësinë e procesit ligjvënës. Kuvendi ka rol qendror në transpozimin e direktivave evropiane dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve që burojnë nga reformat, duke e bërë transparencën jo vetëm një çështje të brendshme demokratike, por edhe pjesë të standardeve më të gjera evropiane për qeverisje të mirë.

Procedurat e përshpejtuara ligjvënëse e kufizojnë hapësirën për debat publik dhe mund të ndikojnë në mënyrën se si kuptohen e shihen reformat nga qytetarët. Informimi i pamjaftueshëm mund të çojë në perceptimin e reformave si presion i jashtëm, ndërsa shtrohet edhe pyetja nëse “harmonizimi me BE-në” kuptohet si proces teknik apo si proces politik që kërkon diskutim më të gjerë.

8 Cygan A. (2021) Participation by national parliaments in the EU legislative process. ERA Forum Journal of the Academy of European Law, 22 (3). Vegëza: <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC8330181/#Sec8>.

Në këtë kontekst, Kuvendi ka një rol të rëndësishëm si ndërmjetës ndërmjet detyrimeve ndërkombëtare dhe publikut vendor. Përmes debatit parlamentar, reformat mund të fitojnë legjitimitet më të gjerë politik. Njëkohësisht, debatet konfliktuale dhe ato që zgjasin tepër mund ta ngadalësojnë dinamikën e reformave.

Ekulibri ndërmjet shpejtësisë dhe përfshirjes nuk është i thjeshtë, pasi efikasiteti më i madh mund ta kufizojë hapësirën për debat, ndërsa procedurat më të gjata mund ta ngadalësojnë procesin. Mënyra se si Kuvendi e arrin këtë ekuilibër ndikon në perceptimin e qytetarëve dhe në shkallën e përfshirjes së tyre, ku agjenda reformuese paraqet një provë për aftësinë e Kuvendit që të funksionojë njëkohësisht si forum efikas dhe demokratik.

2.2 Trupat kryesore të punës së Kuvendit në procesin e integritit në BE

Në kuptimin institucional, procesi i integritit evropian në kuadër të Kuvendit është i strukturuar rreth disa trupave kyçe parlamentare. **Komisioni për Çështje Evropiane** zë vend qendror, si trup punues amë i përgjegjës për ndjekjen e tërë procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian (acquis communautaire).⁹ Komisioni i shqyrton të gjitha propozim-ligjet që kanë dimension evropian, jep mendime për shkallën e harmonizimit me standardet evropiane dhe shërben si filtër përmes të cilit paketat legjislative të reformave kalojnë para miratimit në seancë plenare.

Përveç Komisionit, një funksion të rëndësishëm koordinues dhe konsultativ ka **Këshilli Nacional për Eurointegritim**. Ky këshill përbën një platformë më të gjerë që përveç deputetëve, përfshin edhe përfaqësues të Qeverisë, ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile. Roli i tij është të sigurojë një konsensus më të gjerë politik dhe shoqëror mbi perspektivën evropiane të vendit, të hapë debate strategjike dhe të ndjekë prioritetet kryesore të reformave. Sipas praktikës së vendosur, Këshilli Nacional kryesohet tradicionalisht nga një deputet nga radhët e opozitës, me qëllim nxitjen e konsensusit më të gjerë politik dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në proces. Në kushte të polarizimit politik, një format i tillë është veçanërisht i rëndësishëm si mekanizëm për ndërtimin e një mbështetjeje të qëndrueshme, mbipartiake për agjendën reformuese.¹⁰

Dimensioni ndërkombëtar parlamentar i procesit të integritit evropian realizohet përmes **Komitetit të Përbashkët Parlamentar ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian**, i cili funksionon si kornizë për dialog të rregullt politik me Parlamentin Evropian. Ky mekanizëm mundëson komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet deputetëve nga të dyja palët, shkëmbim qëndrimesh mbi progresin e reformave dhe artikulim të pritjeve që lidhen me procesin e integritit. Në këtë mënyrë, Kuvendi nuk është vetëm një aktor i brendshëm ligjvënës, por edhe pjesëmarrës aktiv në diplomacinë parlamentare evropiane.

9 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Sekretarijati për Çështje Evropiane, Platforma institucionale dhe parimet për zhvillimin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian (Институционална платформа и принципи за водење на преговорите за пристапување на Република Македонија во Европската унија), 11.2007. Vegëza: <https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/pregovori-i-nova-metodologija-file-GrBh.pdf>

10 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Rezolutë mbi prioritetet në vitin 2009 për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian (Резолуција за приоритетите во 2009 година за пристапувањето на Република Македонија во Европската унија), 15.12.2008. Vegëza: <https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/registar-na-dokumenti-i-file-pbtn.pdf>.

Kuvendi ka rol thelbësor në verifikimin demokratik të agjendës së reformave të BE-së, duke siguruar legjitimitet juridik dhe politik përmes votimit dhe debatit. Roli aktiv i Kuvendit parandalon që integrimi të reduktohet në një proces administrativ dhe, përmes strukturës së tij institucionale, përkatësisht përmes Komisionit për Çështje Evropiane, Këshillit Nacional për Eurointegrimedhe bashkëpunimit ndërparlamentar me Parlamentin Evropian, konfirmon pozitën e tij qendrore në procesin e afrimit drejt BE-së.

2.3 Perspektivë krahasuese (Kroaci–Slloveni–Shqipëri)

Integrimi evropian, në kuptimin më praktik, shndërrohet në punë ligjvënëse: miratim të ligjeve të reja, ndryshim të ligjeve ekzistuese dhe përshtatje të rregullave institucionale me standardet e BE-së. Në një proces të tillë, Kuvendi përballet me presion të dyfishtë: nga njëra anë, nevojën për shpejtësi dhe përmbushje të afateve, dhe nga ana tjetër, nevojën për debat demokratik, transparencë dhe legjitimitet. Pothuajse të gjitha sistemet parlamentare kanë mekanizma që mundësojnë miratim të përshpejtuar të ligjeve; dallimet qëndrojnë në mënyrën se si përcaktohen kushtet, kush vendos dhe çfarë shkurtohet (koha, fazat, debati publik).¹¹

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Rregullorja e Kuvendit parashikon në mënyrë të qartë mundësinë që një propozim-ligj të shqyrtohet me procedurë të shkurtuar kur nuk bëhet fjalë për harmonizim të ndërlikuar ose të gjerë me legjislacionin evropian. Në procedurën e shkurtuar, pothuajse të gjitha afatet kohore shkurtohen dhe thjeshtohet rrjedha e shqyrtimit të ligjit krahasuar me procedurën e rregullt. Në vend që procedura të zhvillohet në disa faza të njëpasnjëshme me afate prej disa ditësh ose javësh, procedura e shkurtuar parashikon që trupi punues amë dhe Komisioni Juridiko-Ligjvënës të shqyrtojnë ligjin menjëherë (brenda 6 deri në 24 orësh), seancat e tyre të përfundojnë brenda tri ditësh, ndërsa leximi i dytë dhe i tretë të zhvillohen në të njëjtën seancë, ku amendamente mund të paraqiten deri në fillimin e leximit të tretë. Në procedurën e rregullt, ndërkaq, leximi i parë zhvillohet në afate më të gjata, seanca për leximin e parë mbahet brenda 10 deri në 20 ditë pune, ekziston mundësia për debat publik për ligje me interes më të gjerë, amendamentet paraqiten brenda afateve të përcaktuara paraprakisht, ndërsa leximi i dytë dhe i tretë, si rregull, zhvillohen në faza të ndara, me raporte dhe harmonizime shtesë.

Rregullorja e Kuvendit parasheh një regjim të veçantë dhe të kufizuar në kohë për ligjet që lidhen me harmonizimin me BE-në, me afate të shkurtra për debat dhe kohë të kufizuar për diskutim. Kjo mundëson miratim më të shpejtë, por edhe debat më të kufizuar. Shembujt krahasues të përzgjedhur nuk janë të rastësishëm: Sllovenia si një ndër vendet më të avancuara në rajon, Kroacia me përvojë të ngjashme të anëtarësimit dhe Shqipëria si vendi më i avancuar në negociatat aktuale. Qëllimi nuk është renditja, por paraqitja e qasjeve të ndryshme ndaj përshpejtimit dhe qartësisht të dilemave në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut.

11 A. Koops, J., Costea, S., Pelosi, G., Rishko, V., Strelkov, A., Tentler, M., Parlamentet në procesin e zgjerimit të BE-së: Forcimi i kapaciteteve të parlamenteve të vendeve të anëtarësimit sipas metodologjisë në zhvillim e sipër të zgjerimit (Parliaments in the EU enlargement process: Strengthening capacities of accession country parliaments under the evolving enlargement methodology), Parlamenti Evropian, 01.2025. Vegëza: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2025/754467/EXPO_STU\(2025\)754467_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2025/754467/EXPO_STU(2025)754467_EN.pdf)

2.3.1 Kroacia: procedura urgjente si një vendim i dukshëm e i qartë parlamentar

Kuvendi kroat ka një procedurë urgjente të përcaktuar qartë. Kërkesa për miratimin e një ligji me procedurë urgjente i paraqitet kryetarit të Kuvendit jo më vonë se 24 orë para përcaktimit të rendit të ditës, ndërsa për të vendoset me votim gjatë përcaktimit ose plotësimit të rendit të ditës. Ky është një moment i rëndësishëm krahasues, sepse “shpejtësia” bëhet e dukshme si vendim konkret parlamentar: urgjenca nuk është vetëm çështje administrative apo teknike, por edhe një çështje për të cilën parlamenti vendos në mënyrë të drejtpërdrejtë në kuadër të menaxhimit të rendit të ditës. Sfida kryesore për qytetarët mbetet të kuptojnë pse shumica këmbëngul në urgjencën e ligjit dhe çfarë ndryshon realisht me atë ritëm të përshpejtuar. Në raport kontekstin e Maqedonisë së Veriut, ky shembull ndihmon për të kuptuar “ku qëndron përgjegjësia” kur procesi përshpejtohet dhe nëse qytetarët e shohin këtë vendim si një hap të qartë politik që mund të shpjegohet dhe të ndiqet, apo si një “rutinë” që ndodh pa sqarim të mjaftueshëm.

2.3.2 Sllovenia: përshpejtimi përmes shkurtimit të fazave të debatit

Sllovenia ofron një formë tjetër të qartësisë procedurale. Përshkrimi zyrtar i procedurës ligjvënëse thekson se në procedurë të shkurtuar dhe urgjente *nuk mbahet debat i përgjithshëm*, ndërsa leximi i dytë dhe i tretë zhvillohen në të njëjtën seancë. Kjo do të thotë se përshpejtimi nuk nënkupton vetëm “afate më të shkurtra”, por edhe shkurtim ose bashkim të fazave të debatit parlamentar. Nga perspektiva e qytetarit, ky është një moment thelbësor: me zvogëlimin e fazave, kufizohet koha gjatë së cilës publiku mund ta ndjekë debatin, t’i kuptojë argumentet dhe të reagojë në kohë ndërmjet leximeve. Modeli slloventregon se sistemi mund të sqarojë hapur se çfarë nënkupton “urgjente” ose “e shkurtuar”, pra më pak faza dhe më pak debat i përgjithshëm. Kjo i mundëson publikut të vlerësojë nëse një ligj i caktuar e justifikon këtë shkurtim apo kërkon një debat më të gjatë.

Në kushtet e Maqedonisë së Veriut, kjo ndihmon në sqarimin e një pyetjeje që shpesh qëndron pas kritikave publike: nëse procedurat e përshpejtuara (në përgjithësi dhe sidomos në kuadër të harmonizimit me BE-në), e ngushtojnë realisht hapësirën për debat dhe për amendamente dhe nëse kjo përbën një “çmim të pranueshëm” për ritmin dhe efikasitetin e procesit.

2.3.3 Shqipëria: përsheptimi me “prag minimal kohor” si kornizë mbrojtës

Shqipëria është interesante për shkak të zgjidhjes kushtetuese që mundëson të ashtuquajturën procedurë të përsheptuar, por me një minimum të përcaktuar: shqyrtimi ose miratimi me procedurë të përsheptuar mund të kërkohet nga Qeveria (Këshilli i Ministrave) ose nga një e pesta e deputetëve, por “jo më herët se një javë nga fillimi i shqyrtimit”.¹² Ky “prag minimal kohor” mund të kuptohet si një përpjekje që përsheptimi të mos lë përshtypjen e një “befasie” të plotë. Edhe kur ka urgjencë, ekziston të paktën një javë që publiku, mediat dhe palët e interesuara të informohen se çfarë propozohet dhe të formojnë qëndrimin e tyre. Natyrisht, një javë mund të jetë e pamjaftueshme për reforma të ndërlikuara dhe të ndjeshme, por vlera krahasuese e këtij shembulli qëndron pikërisht te dilema ndërmjet shpejtësisë së procesit dhe parashikueshmërisë dhe qartësisë së tij.

Të gjitha këto aspekte janë veçanërisht të rëndësishme për harmonizimin me BE-në, sepse ai shpesh shihet si proces që duhet të zhvillohet shpejt. Krahasimi tregon se pyetja nuk është nëse shpejtësia lejohet (ajo lejohet pothuajse kudo), por si sigurohet qartësia, parashikueshmëria dhe debati publik në kushte përsheptimi..

12 Treneska, J., Harmonizimi i legjislacionit nacional me legjislacionin evropian: Përmbledhje krahasuese e Maqedonisë së Veriut me Shqipërinë dhe Serbinë (Harmonization of national legislation with EU Law: Comparative overview of North Macedonia with Albania and Serbia) 12.2023. Vegëza: <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2024/01/ENGHarmonizacija-na-nacionalnoto-zakonodavstvo-so-zakonodavstvoto-na-EU-7.pdf>.

2.4 Argumente

Opsione	Argumente „pro“/Mundësi	Argumente „kundër“/Sfida
Miratimi i përshpejtuar i ligjeve të BE-së	Mundëson përmbushjen e detyrimeve në kohë që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE dhe shmangien e vonesave.	Mund ta kufizojë hapësirën për debat parlamentar dhe publik.
Transparenca formale (informacioni i publikuar)	Siguron qasje institucionale në informacion dhe përmbush detyrimet për transparencë.	Nuk garanton që qytetarët i kuptojnë ligjet dhe pasojat e tyre.
Transparenca thelbësore (shpjegimi dhe kuptimi)	E rrit nivelin e informimit dhe mundëson përfshirje më të madhe të publikut në proces.	Është e vështirë të përcaktohet kufiri mes shpjegimit dhe interpretimit, kështu që ekziston rreziku që publiku të krijojë një imazh të njëanshëm të zgjidhjeve ligjore.
Debati parlamentar dhe procedurat më të gjata	Siguron më shumë legjitimitet dhe mundëson përfshirjen e aktorëve të ndryshëm.	Mund ta ngadalësojë dinamikën e reformave dhe të ndikojë në ritmin e përmbushjes së detyrimeve ndaj BE-së.
Vendim i qartë dhe i dukshëm për urgjencën (Kroacia)	Rrit llogaridhënien politike dhe transparencën e vendimmarrjes për përshpejtim.	Mund të përdoret nga shumica pa arsyetim të mjaftueshëm.
Shkurtimi i fazave të debatit (Sllovenia)	Rrit efikasitetin përmes miratimit më të shpejtë të ligjeve.	Zvogëlon kohën që publiku të ndjekë dhe të kuptojë debatin.
Prag minimal kohor për reagim (Shqipëria)	Siguron një periudhë minimale për informimin dhe reagimin e publikut.	Mund të jetë i pamjaftueshëm për reforma komplekse dhe ligje të ndërlikuara..
Roli i Kuvendit si ndërmjetës mes detyrimeve të BE-së dhe publikut vendor	Përmes debatit parlamentar, reformat mund të përshtaten me kontekstin vendor dhe të fitojnë legjitimitet.	Nëse hapësira për debat është tepër e kufizuar ose nëse qëndrimet janë të përcaktuara paraprakisht, Kuvendi mund të duket si një institucion që vetëm formalizon detyrimet, në vend që të jetë një hapësirë për shqyrtimin e tyre thelbësor.
Përshtatja e zgjidhjeve të BE-së me kontekstin vendor	Debati parlamentar mund të ndihmojë që standardet evropiane të përkthehen në zgjidhje që i përshtaten më mirë kushteve vendore institucionale, politike dhe shoqërore.	Interpretimet shumë të gjera dhe përshtatjet e mëtejshme mund ta ngadalësojnë procesin dhe të krijojnë rrezik për harmonizim të papërshtatshëm.
Ekulibri ndërmjet efikasitetit dhe demokracisë	Mundëson njëkohësisht avancimin e reformave dhe ruajtjen e standardeve demokratike.	Vështirë arrihet në kushte të polarizimit politik dhe presionit kohor.

